



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 54, Datë 02.04.2024

MBI

HEQJEN E PEZULLIMIT TË VENDOSUR ME VENDIMIN NR. 240, DATË 03.08.2023 DHE MOSMIRATMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “TEODORI 2003” SH.P.K. PËR TRANSFERIMIN E PJESSHËM TË LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR HEC-IN ZALLI I BULQIZËS, TE SHOQËRIA “KONCESIONARE TËRNOVË ZALL BULQIZË” SH.P.K

Në mbështetje të neneve 16, 43 dhe 44 të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15 dhe 17 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 601/1 prot., datë 29.03.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes, “Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin nr. 240, datë 03.08.2023 dhe mosmiratimin e kërkesës së shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k. për transferimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, për HEC-in Zalli i Bulqizës, te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 240, datë 03.08.2023, ka vendosur të pezullojë vendimmarrjen e tij në lidhje me transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC-in “Zalli i Bulqizës”, nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k. te shoqëria “KONCESIONARE deri në depozitim e qëndrimit/miratimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Kjo vendimmarrje u mor në rrethanat kur miratimi për transferimin e koncesionit dhe të drejtës së ndërtimit dhe operimit të HEC-it “Zall Bulqizë” është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe duke marrë në konsideratë faktin se përfaqësuesi i MIE-s, në seancën dëgjimore të zhvilluar në ERE në datën 03.07.2023 në kuadër të procedurës së

transferimit dhe modifikimit të licencës si më sipër, ka deklaruar se procedura për transferimin e koncesionit është në vlerësim e sipër dhe se do të shqyrtohet në tërësi përpara se të merret një vendim përfundimtar, duke evidentuar dhe faktin se kontrata e koncesionit ka detyrime, për mospërmbushjen e të cilave ka penalitete e si e tillë është duke u shqyrtuar me interes nga MIE.

- Me shkresën nr. 1202/41 prot., datë 16.08.2023, ERE ka njoftuar për vendimin e Bordit nr. 240/2023, palët e përfshira në këtë procedurë, konkretisht shoqërinë “TEODORI 2003” shpk, shoqërinë “TEODORI” sh.p.k., shoqërinë “KONCESIONARE TËRNOVË ZALL BULQIZË” sh.p.k., dhe ka vënë në dijeni Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, z. L.L (administrator i shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k.), shoqërinë “ALBANIA HYDRO INVESTMENTS HOLDING” shpk (ortak i shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k.), znj. Sh.N. (ortak i shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k.), dhe OTP BANK ALBANIA sh.a.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, në ERE është depozituar shkresa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1346 prot., datë 07.02.2024, protokolluar në ERE me nr. 601 prot., datë 08.02.2024, drejtuar shoqërisë “TEODORI” sh.p.k., për dijeni ERE dhe Shoqëria Koncesionare “TEODORI 2003” shpk, ku ndër të tjera MIE është shprehur se *nuk jep pëlqimin mbi transferimin e licencës Nr. 83, datë 04.11.2009, nga shoqëria koncesionare “Teodori 2003” sh.p.k. tek shoqëria “Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.*
- Me depozitimin e qëndrimit të MIE-s sa më sipër, rezulton se nuk ekziston më kushti pezullues i vendimit të bordit të ERE-s nr. 240/2023, e në të tilla rrethana vlerësohet të vijohet me heqjen e këtij pezullimi dhe marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me kërkesën e shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k. për transferimin e pjesëshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC-in Zalli i Bulqizës, te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.
- Duke qenë se miratimi/qëndrimi i Autoritetit Shtetëror Përgjegjës është një nga kërkesat e nenit 17 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, në lidhje me transferimin e licencës, e në përputhje me qëndrimin e MIE-s të depozituar për këtë procedurë, vlerësohet të mos miratohet kërkesa e “TEODORI 2003” sh.p.k. për transferimin e pjesëshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, për HEC-in Zalli i Bulqizës, te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.
- Po ashtu, vlerësohet të mos miratohet dhe modifikimi i pjesëshëm i licencës, i cila ka filluar me nismë të ERE-s, referuar përcaktimeve të nenit 17, pika 3 të Rregullores, ku parashikohet se *Në rastin e transferimi të pjesëshëm të asetëve, ERE zbaton të njëjtat procedura si për transferimin e plotë të përshkruar në pikën 2 por para se të vendosë për licencimin e personit*

tek i cili do të transferohen pjesërisht asetet, do të kryejë modifikimin e licencës të personit të licencuar që ka kryer transferimin e pjesëshëm të aseteve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e bordit nr. 240, datë 03.08.2023 “Mbi pezullimin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k. për transferimin e pjesëshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, për HEC-in Zalli i Bulqizës, te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k”.
2. Të mos miratojë kërkesën e shoqërisë TEODORI 2003” sh.p.k. për transferimin e pjesëshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike nr. 87, seria PV09K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 04.11.2009, vetëm për HEC-in Zalli i Bulqizës, te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k”.
3. Të mos miratojë kërkesën për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nr. 87, seria PV09K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 04.11.2009, vetëm për HEC-in “Zalli i Bulqizës”, me kapacitet të instaluar 5.350 MW.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “TEODORI 2003” sh.p.k., shoqërinë “TEODORI” sh.p.k., shoqërinë “KONCESIONARE ZALL BULQIZË” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Z. L. L., Znj. Sh. N., shoqërinë “ALBANIA HYDRO INVESTMENT HOLDING” sh.p.k. dhe bankën “OTP ALBANIA BANK” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI